



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 24.03.2016 në orën 15:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala n-302

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Luljeta Gutaj-Veselaj, Bislim Zogaj, Slobodan Petroviç, Arben Gashi, Vjosa Osmani dhe Kujtim Paçaku .

Munguan: Xhavit Haliti, Teuta Sahatqija, Ilir Deda, Valdete Bajrami, dhe Time Kadrijaj.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi zëvendëskryetari i dytë i Komisionit, z. Slobodan Petroviç.

Në mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033, si dhe Ligjin nr. 04/L-115 me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 3. Të ndryshme.**

Zëvendëskryetari i dytë i Komisionit, z. Slobodan Petroviç, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, hapi mbledhjen.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033, si**

dhe Ligjin nr. 04/L-115 me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi, lidhur me këtë projektligj, paraqiti opinion ligjor, duke konstatuar se ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së. Raporti i Komisionit funksional përmban një amendament, i cili nuk është në kundërshtim me acquisin të BE-së, andaj hapi debatin.

Pasi nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit, kryesuesi konstatoi se Komisioni nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033, si dhe Ligjin nr. 04/L-115, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, dhe si i tillë, mund të procedohet për miratim në Kuvend.

3. Të ndryshme

Kryesuesi pyeti anëtarët e Komisionit se a ka ndonjë çështje për diskutim.

Pasi nuk u paraqit askush për diskutim, kryesuesi e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zëvendëskryetar i dytë i Komisionit,

z. Slobodan Petrović
